



Lajmëtari i Radio Marisë

Mars 2011

Viti III, Nr. 3

Në këtë numër do të lexoni

Vullnetarët e Radio Marisë	2
Martesa dhe pastërtia paramartesore	3
Shujta shpirtërore 'Lulet e Shpirtit'	4

Lajmëtari i Radio Marisë është organ i Shoqatës Radio Maria.

Tiranë

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 4

Fushë Kërçik

Babrru, Paskuqan

Tiranë, Shqipëri

+355 4 2 346 346

Shkodër

Sheshi Papa Gjon Pali II

Shkodër, Shqipëri

+355 22 24 08 52

E-mail

info@alb.radiomaria.org

Përgjegjës

Don Prekë Lazraj

**Radio Maria,
Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde,
mund të dëgjohet në:**

Prishtinë e rrethina

FM 100.7 MHz

Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat

FM 91.4 MHz

Shkodër, Podgoricë, Ulqin

FM 102.2 MHz

Lezhë, Laç të Kurbinit, Mamurras

FM 89.6 MHz;

Pukë, Fushë Arrëz, Tropojë,

Kukës dhe Kosovë

FM 90.0 MHz

www.radiomaria.al

EDITORIAL

Koha e kreshmëve është kohë kur Hyji na fton që të bëjmë një ndryshim jetësor. Kreshmët janë koha e premtimeve të mëdha, e shpresës së madhe, koha më serioze e më e frytshme gjatë vitit. Të gjithë jemi të ftuar që gjatë kreshmëve të bëjmë diçka të veçantë, të meditojmë për cilësinë e jetës sonë, për punët tona të përditshme në lidhje me Hyjin. Për këtë arsye nuk guxojmë assesi që kohën e kreshmëve ta kuptojmë si kohë dhimbjeje, por si pranverë të jetës dhe si mundësi që të jemi më të shëndoshë, më të mirë dhe më fisnikë.

Këtyre ditëve, pyetja e përgjithshme është – çfarë do të mohosh në kreshmë? Pas kësaj pyetjeje dëgjojmë përgjigje nga më të ndryshmet. Shumica prej tyre qoftë për shkak të paraqitjes, qoftë për shkak të nevojës, janë përgjigje që bashkëbiseduesi sipërfaqësor i kërkon – do ta lë duhanin, nuk do të ha ëmbëlsira, nuk do të pi alkool...

Rrallëkush do të na përgjigjet se thjesht do të jetë njeri më i mirë, do të mënjanojë veprimet e sjelljet e këqija, padurimin, përshpejtimet, vullnetin e keq... Proveni të mendoni ditën mes njerëzve që jetojnë së bashku dhe kanë vendosur që të mos nervozohen. Me durim do t'ia shtrinim dorën më të voglit në familje që ta kënaqim kureshtjen e tij kur pyet se çfarë solli macja para shtëpisë. Nuk do t'i gjuanim duarve dhe fëmija nuk do të qante, nuk do të hidhëroheshim dhe nuk do të na brente ndërgjegjja se kemi qenë tepër të rreptë kur e kemi qortuar fëmijën se është shumë i ngadalshëm. Derën e garazhit do ta mbyllim me kujdes që dera të mos përplasej e që të mos na vrasë me forcën e saj. Gruaja nuk do të dëgjonte fjalë të pahijshme ngaqë e pyetëm të nervozuar nëse kemi në shtëpi gjësend për të mjekuar dorën. Gjatë ngarjes së makinës nuk do të nervozoheshim kur të shihnim para nesh shoferët e shkujesur, dhe qetësinë e mëngjesit nuk do ta merrte djaloshi që rri në parking e na kërkon para për vendin e parkimit që na gjeti.

Dyzet ditë pendese të atyre që u ranë mohit ëmbëlsirave do të kalojnë në dyzim të vazhdueshëm – të marrë ndonjë ëmbëlsirë të dielën apo ta mbajë pendesën. Ndërsa ata që pinë duhan, fatkeqësisht pas dyzet ditëve do të pinë duhan edhe më shumë, ata që mohuan alkoolin, pas kalimit të kreshmëve do ta pinë edhe më shumë. E pra, kreshmët janë kohë kur duhet bërë një ndryshim jetësor..., mundësi që të jemi më të shëndetshëm, më të mirë dhe më fisnikë. Ndër ne zakonet e të mërkurës së përhirë janë në përputhje me praktikën dhe pak

a shumë kanë të bëjnë me gjërat ushqimore, por ishte dashur që ta përfshijnë jetën tonë në tërësi. Mendoni sa do të ishte mirë dhe sa fisnikë do të ishim po ta fillonim çdo ditë të kreshmëve me ndonjë vepër të mirë, me ndonjë mirësi të treguar ndaj të afërmit dhe ndaj të panjohurit, por pa harruar as njerëzit me të cilët jetojmë dhe punojmë. Bukuria dhe pasuria është në dhurim. T'u dhurojmë të tjerëve bukurinë e buzëqeshjes, të mendimeve të pastra, të sinqeritetit dhe të mirësisë. A mund të mendojmë se ku do të na shpinte kjo gjë dhe sa kënaqësi do t'i jepte secilit prej nesh ky parim me të cilin fillojmë ndryshimin që nga fillimi i kreshmëve. Atëherë do të mund të presim që e mira të na kthehet me të mirë, kështu që ndoshta edhe ndaj nesh do të jetë dikush i dashur në sportel, në furrë, në shitore...

Në këto kushte mund të presim që edhe politikanët do të fillojnë të sillen më me përgjegjësi, urti e inteligjencë duke marrë vendime që do t'i shtynin njerëzit e përgjegjshëm që me studimin e vet të shohin se çfarë i nevojitet këtij populli të vuajtur për të ardhmen në të gjitha nivelet, duke biseduar së bashku dhe duke paraqitur zgjidhjen e problemeve. Pa këtë ndryshim, a mund të shpresojmë se marrëdhënia e tyre ndaj shoqërisë e ndaj nesh do të jetë strategji që shikon zhvillimin dhe përparimin e vërtetë të fshatrave e qyteteve tona? A mund të shpresojmë se do të jemi më afër njëri-tjetrit? A mund të mendojmë se është vërtet e mundur që ta ndjejmë vëllazërinë, kuptimin, mirësinë ndaj secilit njeri pa marrë parasysh dallimet që ekzistojnë në shoqërinë tonë dhe mes nesh? Ose ndoshta na duhet ende të mendojmë se na duhet edhe më që të jetojmë nën trysinë e zgjedhjeve politike që janë shndërruar në një cirk të vërtetë në të gjitha nivelet e politikës sonë. Kështu, premtimet për jetë më të mirë, perspektiva më të qarta, mundësi më të mira i kemi vetëm në fushata. Pastaj vijnë ditët plot mjeçull e errësirë që përpiqen ta fshehin para nesh gjendjen e vërtetë, duke paraqitur diskutimet dhe kundërshtimet, shkandujt e qenë dhe të paqenë vetëm e vetëm që të mos përgjigjen në pyetjet shqetësuese: pse gjithnjë e më shumë bashkëqytetarë të vendit tonë jetojnë gjithnjë e më keq? Përse rritet gjithnjë e më shumë papunësia dhe mbyllen bizneset? Përse brezave të rinj iu vritet e ardhmja?

Paç ndihmën e Zotit për të filluar ndryshimin e jetës!

Don Preka

VULLNETARËT E RADIO MARISË

Qoftë LëvdUAR Jezu Krishti!

Unë që po shkruaj këtë letër quhem Alketa Gega dhe jam një ndër vullnetaret e Radio Marisë dhe marr pjesë rregullisht në takimet që i zhvillojmë në Tiranë. Jemi një grup nismëtarësh të rinj që mbledhemi dhe shkojmë në takimin e përjavshëm të vullnetarëve në Radio Mari. Ajo i ka gjithmonë krahët e hapura për ne dhe na pret gjithmonë me shumë ëmbëlsi e dashuri.

Çdo të hënë na hapen zemrat dhe nisim një javë për së mbari. Në takimet tona flasim për punët që kemi kryer dhe veprimet që do të ndërmarim, lutemi, kalojmë kohë me njëri-tjetrin, etj. Çdokujt i qeshet buza dhe ne ndihemi vërtet katolikë.

Radio Maria ka një ndërtim tipik e të veçantë. Çdo kush është



i mirëpritur në këtë shtëpi. Aty mbizotëron dashuria, respekti e mirëkuptimi. Nuk ka rëndësi në është i vogël apo i rritur, vajzë apo djalë. Radio Maria i pret të gjithë.

Përveç kësaj, radioja ka një program të larmishëm e të mrekullueshëm për fëmijë, të rinj e të moshuar. Orët në Radio Mari kalohen pa kuptuar. Ne duhet të jemi krenarë që në lagjen tonë është ndërtuar Radio Maria dhe duhet të jemi shumë të kënaqur që në këtë botë jetojnë njerëz si ato që drejtojnë Radion, kaq të

mirë. Iu bëj thirrje çdokujt që do të ndihet më afër me Zotin le të vijë tek Radio Maria. Aty ka punë për çdo njeri. Zoja na pret që ta japim ndihmesën tonë në ungjillëzimin e Shqipërisë.

TË NJOHËSH HYJIN PËRMES SHËRBËTORËVE TË TIJ



Falënderoj nga zemra stafin e Radio Marisë për mundësinë që më ofruan në njohjen e shërbëtorëve të Hyjit, përmes të cilëve tani kam një ndjesi tjetër edhe për vetë Hyjin.

Tani që lexova për shërbëtorët e tij, jam e bindur më shumë se kurrë se Hyji na përdor neve për të përhapur mirësinë dhe fjalën e tij. Dhe gjithsecili prej nesh është shumë i përshtatshëm për të qenë qiriu i Hyjit që e përcjell dritën e Tij në

botë, ashtu siç kanë bërë edhe shërbëtorët e Tij të cituar në Kalendarin e Radio Marisë.

Jeta nuk është fushë me lule, por një udhëtim mes tyre. Çdo hapësirë "djerrë" mes kësaj lulishteje është një provë që Hyji na e ka dhënë për ta kaluar. Shërbëtorët e Hyjit janë shembulli më i mirë për këtë fakt. Hyji na dhëntë vullnetin e nevojshëm për të ecur në rrugën e tij.

Zoti e bekoftë punën tuaj, Radio Maria!

Hana Rrgalla, studente

SI TA NDIHMOJMË RADIO MARINË?

Të dashur miq, duke filluar nga përvoja jonë personale, me të drejtë e quajmë Radio Marinë *HIRI I HYJIT NË SHTËPITË TONA*. Prandaj, duhet të besojmë se aty ku është HIRI I HYJIT, nuk mungon asgjë. Por, kjo vepër e Zotit kërkon mbështetje nga të gjithë, pra edhe nga unë dhe ti që po e lexon këtë shkrim tani.

Në mes të oqeanit të mundësive për ta mbështetur Radio Marinë, kemi menduar që edhe vajzat dhe gratë shqiptare mund ta japin ndihmesën e tyre duke dhuruar ndonjë punë dore të tyre. Ndërsa për shitjen e tyre do të kujdesemi ne në Zvicër, që jemi një grup i vogël i grave shqiptare dhe zvicerane në bashkëpunim me Misionet tona në Zvicër. Për kontaktet mund të drejtoheni te Radio Maria në Tiranë ose në Shkodër, ose përmes adresës së internetit dhe numrit të telefonit të redaksive.

Për një gjë jemi të vetëdijshëm: bujku kur e mbjell arën, për një kohë duket se fara ka humbur në dhé. Por, sapo të piquen kushtet, fara mbin, rritet dhe jep fryt shumëfish.

Besoje se ky është një krahasim shumë i vogël krahasuar me shpërblimet që i marrim nga Hyji.

Dikush tha: «askush nuk është aq i varfër saqë të mos ketë mundësi të dhurojë asgjë dhe askush nuk është aq i pasur saqë të mos ketë nevojë për asgjë».

Të ftoj edhe ty që me dhuratën tënde të dashurisë të bashkohesh me këtë nismë për të ndihmuar Radio Marinë me punëdoret e tua që ke mundësi t'i dhurosh.

Një dëgjuese e Radio Marisë në Zvicër

A DUHET TË FLASIN MESHTARËT MË SHUMË PËR BESNIKËRINË NË MARTESË DHE PËR PASTËRTINË?

Një ditë pata mundësi të dëgjoj një bisedë mes të rinjve. Flisnin për planet e ndryshme jetësore të të ardhmes, ashtu siç bëjnë shumë shpesh adoleshentët. Më vonë njëri prej tyre pyeti haptas: Kur të rritemi, a është më mirë të martohemi apo të jetojmë me një person si burrë dhe grua, por pa e ngarkuar vetveten me formalitetet e martesës?

Disa thanë se është më mirë të mos e lidhin aspak martesën, sepse detyrimet në këtë lidhje janë shumë më të vogla, dhe se është më mirë të mos marrim mbi vete «detyrimet e rënda», sepse «kurrë s'i dihet». Por edhe për «t'u kthyer prapa» nuk ka hapësirë kur je i martuar.

Duke dëgjuar këtë bisedë fillova të mendoj: çfarë ndikimi kanë te të rinjtë tanë mjetet e informimit me transmetimet e veta shumë të dyshimta dhe telenovelat në të cilat paraqiten «modelet jetësore». Mirëpo më shkoi ndër mend ta pyes veten edhe për ndikimin e meshtarëve dhe të Kishës në përgjithësi te të rinjtë tanë. Të rinjtë që po bisedonin kështu i njoh shumë mirë. Ata janë të rregullt në mësim feje, shkojnë në meshë e disa prej tyre janë pjesëtarë të grupeve të ndryshme që veprojnë në famullitë tona. Mendova, çfarë vlerash marrin këta të rinj në këto bashkime? Shumë meshtarë dhe motra shumë shpesh edhe nga altari flasin për solidaritetin, se si duhet të pranojmë njerëzit që nuk janë si ne, se nuk duhet të jemi vetja... Të gjitha këto janë në rregull, por, përse nuk flasin për besnikërinë paramartesore dhe në martesë, për mbrojtjen e jetës, për pastërtinë? Ndoshta mendojnë se në këtë mënyrë do të humbasin të rinjtë?

Noshi, Shtoj




Jeta morale, të cilën e propozon Kisha Katolike që nga Ati i shenjtë e deri të famullitari në famullinë më të largët të kësaj bote, nuk ka ndryshuar. Edhe predikimi dhe shpallja që bën Kisha është i njëjtë, aq sa aty-këtu dëgjohej njerëzit duke thënë: «Gjithmonë predikohet e njëjta gjë, kjo është paksa e mërzitshme...» Edhe sa i përket Katekizmit të Kishës Katolike, nuk kemi kurrfarë ndryshimesh. «Kenë mundësi ta vërtetoni» atë gjë që ju ka mësuar famullitari juaj kur ishit të rinj me Katekizmin e përparshëm në krahasim me Katekizmin e Kishës Katolike që u promovua para dhjetë viteve dhe do të shihni se nuk ka ndryshime në mësim, në aspektin moral dhe në lëmitë e tjera. Sot, dëgjimi i këtij mësimi dhe kjo porosi e Kishës dhe Ungjillit është në «luftë» me mësimet dhe porositë e tjera të kësaj kohe. Këto «porosi» të botës janë shumë të fuqishme dhe ngashënyese. Duke shkuar sipas logjikës së moskundërshtimit, edhe vetë besimtarët bëhen pre e këtyre mësimëve plotësisht të gabuara.

Mirëpo, një gjë duhet pranuar. As të rinjtë e kohës së djeshme nuk e patën tepër të lehtë në kohën kur atyre iu desh të përballen me pyetjet e ngjashme me ato që u paraqiten të rinjve të sotëm, të shpjegosh vlerat e modelit të martesës të një burri dhe të një gruaje që duhet jetuar në besnikëri, në përkim me shpalljen e krishterë. Mirëpo më duhet të them se meshtarëve tanë iu desh të përballen më fuqishëm dhe të luftojnë turpin e jetës aq të pamoralshme që shumë është e përhapur si shkandull në ditët tona.

Konsumizmi seksual dhe propozime nga më të ndryshmet nuk kundërshtojnë vetëm moralin katolik, por edhe arsyen e shëndoshë njerëzore dhe shijen e mirë. Këto gjëra nuk i shkandullojnë vetëm ata që janë më të fortët dhe më tradicionalët në mesin e njerëzve, por sot shkandullohen edhe ata pjesëtarë të shoqërisë sonë të cilët në mënyrë publike deri më sot janë deklaruar publikisht se janë «tolerantë». Për këtë gjë, a do të pushojmë së foluri për martesën e krishterë? Assesi!

Mirëpo, pikërisht duke folur për të rinjtë dhe pastërtinë paramartesore dhe besnikërisë martesore, secili meshtar dhe edukator është i ftuar që të rinjve t'u tërheqë vërejtjen përpara modeleve të gabueshme të jetës që paraqiten sot si modele «normale», dhe t'i nxisin që të jenë të gatshëm të përballen edhe me të gjithë ata që do t'i konsiderojnë njerëz që «nuk përshtaten dot».

T'u rrih besnik parimeve dhe të jesh besnik në jetë nuk do të thotë se je i prapambetur, as konservator. Të fillosh martesën me një vajzë/djalë do të thotë në mënyrë të hapur ta pranosh dashurinë duke u hapur para jetës dhe personit ndaj të cilit do të jesh besnik/e deri në mbarim të jetës, sepse vetëm kështu përplotësohet martesë.



LIBRI I RI LULET E SHPIRTIT



Më në fund lexuesi shqiptar po merr në dorë librin “Lulet e shpirtit”, me të cilin mund të plotësojmë boshllëkun e shumë përshpirtërive të reja që Zoti ia dhuroi Kishës, por nuk i kishim të përmbledhura në një libër të lutjeve të miratuara nga autoriteti kishitar. Me këtë rast falënderojmë drejtorin e Radio Marisë Shqiptare, Don Prekë Lazrajn, që ia bëri të mundur lexuesit shqiptar pasjen e këtij libri, me qëllim që të ushqehet për çdo ditë dhe të rritet në fe, shpresë dhe dashuri. Një falënderim të veçantë edhe Imzot Gjergj Frendos, lëshkvi të ndihmës Tiranë–Durrës, si dhe përgjegjësit të sektorit në Konferencën lëshkvnore të Shqipërisë, që e shikoi dhe e miratoi këtë libër të rëndësishëm për çdo besimtar katolik. Falënderojmë edhe motrat e Nënë Terezës në Shqipëri që kërkuan me këmbëngulje botimin e një libri të tillë në dobi të secilit njeri që do ta lexojë dhe do të lutet me të.

Ky libër e përcjell besimtarin duke ia zbuluar të gjitha misteret e fesë së krishterë duke filluar me lutjet themelore që përfshijnë momentet e vazhdueshme të jetës së njeriut. Një ndër pikat kryesore të këtij libri është ndihmesa që ia jep besimtarit për të marrë pjesë në Meshën e shenjtë duke shpjeguar në pika të shkurtra së pari Meshën, themelin e jetës së secilit njeri.

Në të njëjtën mënyrë jemi të udhëhequr në kuptimin e hirit që marrim përmes të gjitha sakramenteve duke na dhënë një përmbledhje të shkurtër për kuptimin e secilit sakrament. Sa i përket Kungimit, lexuesi gjen përgatitjen e duhur për të marrë Krishtin në zemër si edhe lutjet e falënderimit që Kungimin e shenjtë e bëjnë të frytshëm në jetën tonë. Rrëfimi zë një vend të rëndësishëm në jetën e secilit prej nesh. Në këtë libër kuptojmë më mirë

rëndësinë e shqyrtimit të ndërgjegjes, pendimin e plotë dhe pendimin e paplotë dhe marrim diturinë e nevojshme sa iu përket ndjesëve që Kisha nënë i ka përcaktuar për bijtë dhe bijat e veta. Do t'i gjejmë gjithashtu edhe informacionet e nevojshme për rëndësinë e vajimit, urdhrin të shenjtë dhe të kurorës së martesës.

Një kapitull tjetër në këtë libër ka urata ose lutja e cila fillon me shpjegimin e përshpirtërisë më të rëndësishme në jetën e secilit të krishterë që është: Adhurimi i të Shenjtërueshmë Sakrament. Këtu përfshihen litanitë e ndryshme që na ndihmojnë t'i kuptojmë misteret e jetës së Jezu Krishtit Zot e Njeri.

Në pjesën tjetër besimtari ka mundësi të kuptojë rëndësinë e lutjes që bëhet gjatë mistereve që na paraqiten në kohërat e veçanta të vitit kishitar: Ardhja, Kërshëndellat, përfundimi i vitit, fillimi i vitit, Dëftimi i Zotit, Kreshmët, Java e Madhe, Pashkët, Mëshira Hyjnore, të Shëlbuarit, Rrëshajat, Trinia e Shenjtë, Trupi e Gjaku i Krishtit, Zemra e Krishtit, domethënia e të premtëve të para të muajit, kushtime të ndryshme Zembrës së Krishtit, Lartësimi i Kryqit të shenjtë, e diela e misionëve, të gjithë shenjtërit, lutjet për shpirtat e purgatorit. Janë të parapara dy udhë të kryqit dhe disa nëntëditëshe të rëndësishme për jetën dhe nevojat e secilit besimtar.

Aty paraqitet edhe jeta e të krishterit dhe përshpirtëria e tij ndaj Zojës Mari. Vend të rëndësishëm në përshpirtërinë ndaj Zojës zë lutja e rruzares me të gjitha misteret e paraqitura në dy mënyra. Janë të paraqitura të gjitha festat e Zojës gjatë vitit kishitar, si edhe përshpirtëria e Zembrës së Papërlyer të Zojës dhe përshpirtëria e besimtarëve gjatë muajit maj.

Në pjesën e fundit të librit janë paraqitur Shenjtërit, miqtë e Hyjit, në mënyrë të veçantë shenjtërit që Konferenca lëshkvnore e Shqipërisë kërkoi nga Selia e shenjtë që të kremtohen në popullin tonë në mënyrë të veçantë. Vend të rëndësishëm ka përshpirtëria ndaj Shën Jozefit, Shën Antonit të Padovës, Shën Luigjit, të Lumes Terezë të Kalkutës, Shën Mikelit, Gabrielit dhe Rafaelit, Shën Françeskut e Shën Nikollës.

Krejt në fund janë lutjet e nevojshme që bëjmë në raste të ndryshme për Kishën, Atin e Shenjtë, lëshkvi të meshtarët, mbarë popullin e Hyjit në prova e në momente jetësore, duke përfshirë të gjitha nevojat që kemi si njerëz këtu mbi tokë. Libri përmbillet me bekime, të cilat kanë mundësi t'i përdorin në radhë të parë meshtarët, por edhe çdo besimtar aq sa Kisha ia lejon të bëjë.

Libri “Lulet e shpirtit” ofron edhe disa këngë të përshpirtshme që përdoren në kohën gjatë vitit kishitar, por fatkeqësisht jo edhe këngët e kohërave të veçanta. Janë të përfshira këngët më të rëndësishme të Zojës së Bekuar.

Ja, të dashur lexues, një ndihmë shpirtërore për të cilën duhet të kujdeset secili, sepse kështu virtyti Hyjnor do të rritet gjithnjë e më shumë në zemrat tona. Uroj që ky libër të jetë sa më parë i tepërt në marrëdhënien tuaj të gjallë me Zotin e gjallë.

Librin mund ta gjeni në mjediset e Radio Marisë në Tiranë dhe Shkodër, por edhe në të gjitha famullitë ku famullitarët do ta kërkojnë që ta kenë në dispozicion për besimtarët e famullive të tyre.

Orselina Paluca

PRO CREDIT BANK SHKODËR

LLOGARIA NË EURO 600388970102

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 45209516090000600388970102

LLOGARIA NË LEK 600388970001

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 56209516090000600388970001

PRO CREDIT BANK TIRANË

LLOGARIA NË EURO 127837030002

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 05209111240000127837030002

LLOGARIA NË LEK 127837030101

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 48209111240000127837030101

INTESA SAN PAOLO BANK TIRANË

LLOGARIA NË EURO 1043631803

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 25208110080000001043631803

LLOGARIA NË LEK 1043631801

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 79208110080000001043631801